



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të neneve 15.1(f), 21.2 dhe 69 të Ligjit Nr. 03/L- 051 për Aviacionin Civil,

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si "Marrëveshja HPEA") në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes HPEA, për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës përfshirë edhe ato të lidhura në emër të Kosovës nga UNMIK-u,

Me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave që rregullojnë qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në aeroportet e aviacionit civil në Republikën e Kosovës në përputhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe kërkesa e saj që Direktiva e Këshillit 96/67/EC për qasje në tregun e shërbimeve në tokë duhet të bëhet pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 4/2011 PËR QASJEN NË TREGUN E SHËRBIMEVE NË TOKË

Neni 1 Fushëveprimi

1.1 Kjo Rregullore është e aplikueshme për çdo aeroport të vendosur në territorin e Republikës së Kosovës, që i nënshtrohet dispozitave të Marrëveshjes HPEA, i cili është i hapur për trafikun komercial në rrethanat si në vijim:

(a) Dispozitat e Nenit 6.1 në lidhje me kategoritë e shërbimeve në tokë të listuara në Shtojcë, përveç atyre të referuara në Nenin 6.2, do të aplikohen në çdo aeroport pavarësisht dendësisë së trafikut.

(b) Dispozitat në lidhje me kategoritë e shërbimeve në tokë që referohen në Nenin 6.2 do të aplikohen për ato aeroporte, trafiku vjetor i të cilave nuk është më i vogël se 1 milion lëvizje udhëtarësh ose 25.000 tonë mallra.

1.2 Pa paragjykuar paragrafin 1, dispozitat në lidhje me kategoritë e shërbimeve në tokë që referohen në Nenin 7, do të aplikohen në të gjitha aeroportet që janë të vendosura në territorin e Republikës së Kosovës, e që u nënshtrohen dispozitave të Marrëveshjes HPEA, të cilët janë të hapur për trafikun komercial, trafiku vjetor i të cilëve nuk është më i vogël se 2 milionë lëvizje udhëtarësh ose 50.000 tonë mallra.

1.3 Kur një aeroport arrin njërin prej pragjeve të trafikut të mallrave që referohen në këtë nen, pa arritur pragun korrespondues të lëvizjes së udhëtarëve, dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk do të aplikohen në kategoritë e shërbimeve në tokë të rezervuara ekskluzivisht për udhëtarët.

1.4 Shërbimet në tokë të listuara në Shtojcën e kësaj Rregulloreje mund të ofrohen nga:

- (a) Organi menaxhues i aeroportit
- (b) Përdoruesit e aeroportit (vetë shërbyesit)
- (c) Furnizuesit e shërbimeve në tokë

1.5 Republika e Kosovës do të publikojë, për informim, në mënyrën më të përshtatshme të mundur, listën e aeroporteve që referohen në këtë nen, në pajtueshmëri me Ligjin për Aviacionin Civil. Lista së pari do të publikohet brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, dhe më pastaj çdo vit. AAC-ja, para 1 korrikut të secilit vit, do t'i përcjellë Komisionit të dhënave e përdorura për përpilimin e listës.

Neni 2 **Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje:

“aeroporti” nënkupton çfarëdo sipërfaqe tokësore e përshtatur në veçanti për aterrim, ngritje dhe manovrim të avionit, duke përfshirë instalimet ndihmëse që këto operacione mund të përfshijnë për nevojat e trafikut të avionëve dhe shërbimeve duke i përfshirë instalimet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet komerciale ajrore;

“sistemi i aeroportit” nënkupton dy ose më shumë aeroporte të grupuara së bashku për t'i shërbyer qytetit të njëjtë ose një bashkimi urban, siç është referuar në Rregulloren e Këshillit Nr. 1008/2008 të datës 24 shtator 2008, mbi rregullat e

përbashkëta për shërbime ajrore në Komunitet dhe Rregulloren Nr. 2010/01 të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës;

“organi menaxhues i aeroportit” nënkupton organin i cili, në ndërlidhshmëri me aktivitetet tjera ose jo, sipas rastit, ka si objektiv të vet sipas ligjit apo rregulloreve të Republikës së Kosovës administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së aeroportit, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm prezentë në aeroport ose sistemin e aeroportit në fjalë;

“përdoruesi i aeroportit” nënkupton çdo person fizik ose juridik me përgjegjësi për bartjen e udhëtarëve, postës dhe/ose mallrave përmes ajrit deri në, ose prej aeroportit në fjalë;

“shërbimi në tokë” nënkupton shërbimet e ofruara për përdoruesit e aeroporteve, në aeroporte siç është përshkruar në Shtojcë të kësaj Rregulloreje;

“Vetëshërbimi” nënkupton një situatë në të cilën një përdorues i aeroportit në mënyrë direkte ofron për vetëveten një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë dhe nuk lidh asnjë kontratë të çfarëdo përshkrimi me palën e tretë për ofrimin e shërbimeve të tilla; për qëllim të këtij përkufizimi, përdoruesit e aeroportit nuk do të konsiderohen si palë e tretë mes vete kur:

- njëri mban shumicën e aksioneve në tjetrin; ose
- një organ i vetëm mban shumicën e aksioneve në secilin;

“furnizuesi i shërbimeve në tokë” nënkupton çdo person fizik ose juridik që furnizon palët e treta me një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë;

“AAC” nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës;

“HPEA ose Marrëveshja HPEA” nënkupton Marrëveshjen Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, dhe Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës ish Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

“Komiteti i Përbashkët i HPEA-së” nënkupton komitetin e themeluar në bazë të nenit 18 të Marrëveshjes HPEA;

“Komisioni” nënkupton Komisionin Evropian.

Neni 3 **Organi menaxhues i aeroportit**

3.1 Kur një aeroport ose sistem i aeroportit nuk menaxhohet dhe nuk operohet nga një organ i vetëm por nga disa organe të ndara, për qëllim të kësaj Rregulloreje, secila nga këto organe do të konsiderohet pjesë e organeve menaxhuese të aeroportit.

3.2 Ngjashëm, kur një organ i vetëm menaxhues është i përcaktuar për disa aeroporte ose sisteme të aeroporteve, secili nga këto aeroporte ose sisteme të aeroporteve do të konsiderohen ndarazi për qëllime të kësaj Rregulloreje.

3.3 Nëse organet menaxhuese të aeroporteve i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të një autoriteti publik të Republikës së Kosovës, ai autoritet do të jetë i detyruar, në kontekstin e detyrimeve ligjore të dala nga kjo, të sigurojë që kjo Rregullore të aplikohet.

Neni 4 Ndarja e llogarive

4.1 Kur organi menaxhues i një aeroporti, përdoruesi i aeroportit ose furnizuesi i shërbimeve në tokë ofrojnë shërbime në tokë, ata duhet në mënyrë rigoroze të ndajnë llogaritë e aktiviteteve të tyre të shërbimeve në tokë nga llogaritë e aktiviteteve tjera të tyre, në pajtueshmëri me praktikat aktuale komerciale.

4.2 Raporti financiar vjetor i auditorit të pavarur duhet të deklarojë vërejtjet e tij/saj nëse ndarja e llogarive të përmendura në paragrafin 1 është kryer dhe, në raste kur organi drejtues i aeroportit ofron shërbime në tokë, të deklarojë nëse nuk ka qarkullime financiare ndërmjet aktiviteteve të shërbimeve në tokë dhe funksioneve tjera të tij.

4.3 Ndarja e llogarive në paragrafin 1 përfshin ndarjen e të hyrave dhe shpenzimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve në tokë nga të hyrat dhe shpenzimet e aktiviteteve tjera.

4.4 Raporti i auditorit sipas paragrafit 2 do t'i dorëzohet AAC-së jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit të kaluar fiskal.

4.5 AAC-ja mund të zgjedh që të angazhojë auditorin e vet të pavarur për qëllime të sigurimit të përputhshmërisë me këtë nen.

Neni 5 Komiteti i Përdoruesve të Aeroportit

5.1 AAC-ja do të sigurojë që për secilin aeroport në fjalë të themelohet një Komitet i përfaqësuesve të përdoruesve të aeroportit ose organizatave që përfaqësojnë përdoruesit e aeroportit.

5.2 Të gjithë përdoruesit e aeroportit do të kenë të drejtë të jenë në këtë Komitet, ose, nëse ata dëshirojnë, që të përfaqësohen në të nga një organizatë e emëruar për këtë qëllim.

Neni 6 **Vetëshërbimi**

6.1 AAC-ja do të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme në pajtueshmëri me aranzhimet e përcaktuara në nenin 1 për të siguruar lirinë për Vetëshërbim.

6.2 Organi menaxhues i një aeroporti mund të aplikojë me shkrim në AAC që të kufizojë numrin e aprovuar të vetëshërbyesve në një aeroport ose në një pjesë të aeroportit deri në atë numër ashtu siç kërkohet në aplikacion, duke qenë jo më pak se 2, dhe me kusht që ata të jenë zgjedhur në bazë të kriterëve relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, për ndonjë ose për të gjitha kategoritë vijuese të shërbimeve në tokë:

- përpunimin e bagazhit,
- përpunimin në platformë,
- përpunimin e derivateve dhe vajrave,
- përpunimin e mallrave dhe postës sa i përket trajtimit fizik të mallrave dhe postës ndërmjet terminalit ajror dhe avionit, qofshin ato në mbërritje, nisje apo transferim,

Aplikacioni me shkrim nga organi menaxhues i aeroportit duhet të përmbajë arsyetime për kufizimet e propozuara.

6.3 Në mbështetje të aplikacionit sipas paragrafit 2, AAC-ja, në konsultim me "Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit", mund të kufizojë numrin e aprovuar të vetëshërbyesve në aeroport deri në atë numër që AAC-ja e sheh të arsyeshme, duke qenë jo më pak se 2, dhe do të saktësojë:

- (i) aeroportin dhe, aty ku është e përshtatshme, pjesën e aeroportit për të cilin aplikohet,
- (ii) kategorinë e shërbimeve me të cilën ndërlidhet,
- (iii) numrin e vetëshërbyesve të shërbimeve në tokë të autorizuar që të ofrojnë shërbime të tilla, dhe
- (iv) periudhën kohore për të cilën kufizimi do të aplikohet.

6.4 Aty ku numri i përdoruesve të aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen është i kufizuar në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, Vetëshërbimi për kategoritë relevante duhet t'iu lejohet, duke marrë parasysh nenin 11 të kësaj Rregulloreje, atyre përdoruesve të aeroportit të cilët kanë bartur numrin më të madh të udhëtarëve gjatë vitit të kaluar kalendarik prej/në aeroportin në të cilin ata dëshirojnë të vetëshërbehen.

Neni 7

Shërbimet në tokë për palët e treta

7.1 AAC-ja do të ndërmarr hapat e nevojshëm në pajtueshmëri me aranzhimet e përcaktuara në nenin 1 për t'iu siguruar qasje të lirë në treg furnizuesve të shërbimeve në tokë që të ofrojnë shërbime në tokë për palët e treta. Aprovimi i furnizuesve të shërbimeve në tokë do të bëhet nga AAC-ja në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje.

7.2 AAC-ja ka të drejtë të kërkojë që furnizuesit e shërbimeve në tokë të jenë të themeluar brenda Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

7.3 Organi menaxhues i një aeroporti mund të aplikojë me shkrim në AAC për të kufizuar numrin e furnizuesve të aprovuar në një aeroport ose në një pjesë të aeroportit deri në atë numër siç kërkohet në aplikacion, duke qenë jo më pak se 2, për ndonjë ose për të gjitha kategoritë në vijim të shërbimeve në tokë:

- përpunimi i bagazhit,
- përpunimi në platformë,
- përpunimi i derivateve dhe vajrave,
- përpunimi i mallrave dhe postës sa i përket trajtimit fizik të mallrave dhe postës ndërmjet terminalit ajror dhe avionit, qofshin ato në mbërritje, nisje apo transferim.

Aplikacioni me shkrim nga organi menaxhues i aeroportit duhet të përmbajë arsyetime për kufizimet e propozuara.

7.4 Për më tepër, së paku njëri prej furnizuesve të aprovuar mund të mos jetë i kontrolluar direkt ose indirekt nga:

- organi menaxhues i aeroportit,
- ndonjë përdorues i aeroportit i cili ka bartur më tepër se 25 % të udhëtarëve ose mallrave të regjistruara në aeroport gjatë vitit paraprak nga viti në të cilin këta furnizues janë zgjedhur,
- një organ që kontrollon ose kontrollohet në mënyrë direkte ose indirekte nga ai organ menaxhues ose ndonjë përdorues i tillë.

7.5 Në mbështetje të aplikacionit sipas paragrafit 3, AAC-ja, në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit, mund të kufizojë numrin e furnizuesve të aeroportit deri në atë numër që AAC-ja e sheh të arsyeshme, duke qenë jo më pak se 2, dhe do të saktësojë:

- (i) aeroportin dhe, aty ku është e përshtatshme, pjesën e aeroportit në të cilën aplikohet,
- (ii) kategoritë e shërbimeve me të cilat ndërlidhet,

- (iii) numrin e furnizuesve të shërbimeve në tokë të autorizuar për furnizim me shërbime të tilla, dhe
- (iv) periudhën kohore për të cilën kufizimi do të aplikohet.

7.6 Kur në bazë të paragrafit 5, AAC-ja kufizon numrin e furnizuesve të aprovuar, AAC-ja mund të mos e pengojë një përdorues të aeroportit, për cilëndo pjesë që i është caktuar atij, për të pasur një zgjidhje efektive në mes të së paku dy furnizuesve të shërbimeve në tokë, në lidhje me secilën kategori të shërbimeve në tokë që i nënshtrohet kufizimit, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 3 dhe paragrafin 4.

7.7 Në raste kur disa shërbime i janë nën-kontraktuar një furnizuesi të palës së tretë, furnizuesi i një shërbimi të tillë duhet të aprovohet gjithashtu nga AAC-ja.

Neni 8 Infrastruktura e centralizuar

8.1 Pavarësisht aplikimit të nenit 6 dhe 7, AAC-ja, në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit, mund të rezervojë për organin menaxhues të aeroportit apo për një organ tjetër, menaxhimin e infrastrukturës së centralizuar që përdoret për furnizim të shërbimeve në tokë, kompleksiteti i të cilave, kostoja apo ndikimi hapësinor nuk lejon ndarjen ose dyfishimin, siç janë sortimi i bagazhit, shkrirja e akullit, sistemi i pastrimit të ujit dhe shpërndarjes së derivateve. Ata mund ta bëjnë të detyrueshme për furnizuesit e shërbimeve në tokë dhe për përdoruesit e aeroportit që bëjnë Vetëshërbim, përdorimin e kësaj infrastrukture.

8.2 AAC-ja do të sigurojë që menaxhimi i kësaj infrastrukture të jetë transparent, objektiv dhe jo-diskriminues dhe, në veçanti, se kjo nuk pengon qasjen e furnizuesve të shërbimeve në tokë ose përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit në kuadër të kufizimeve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 9 Përgjashtimet

9.1 Kur në një aeroport, kufizimet e veçanta për hapësirën dhe kapacitetet e disponueshme, që dalin në veçanti nga mbipopullimi dhe norma e shfrytëzimit të hapësirës, e bëjnë të pamundur hapjen e tregut dhe/ose zbatimin e Vetëshërbimit deri në nivelin e përcaktuar në këtë Rregullore, AAC-ja, në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit mund të vendosë:

- (a) të kufizojë numrin e furnizuesve për një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë, përveç atyre që referohen në nenin 7.3 në tërë aeroportin ose në ndonjë pjesë të tij; në këtë rast do të aplikohen dispozitat e nenit 7.3 dhe 7.4;

(b) t'i rezervohen një furnizuesi të vetëm një ose më tepër kategori të shërbimeve në tokë të referuara në nenin 7.3;

(c) të rezervojë Vetëshërbimin për një numër të kufizuar të përdoruesve të aeroportit për kategoritë e shërbimeve në tokë përveç atyre të referuara në nenin 6.2, me kusht që këta përdorues të zgjedhen në bazë të kriterëve relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese;

(d) të ndalojë Vetëshërbimin ose t'ia kufizojë atë një përdoruesi të vetëm të aeroportit për kategoritë e shërbimeve në tokë që referohen në nenin 6.2.

9.2 Të gjitha përjashtimet në bazë të paragrafit 1 duhet të:

(a) Saktësojnë kategorinë ose kategoritë e shërbimeve në tokë për të cilat është aprovuar përjashtimi dhe kufizimet e veçanta për hapësirën apo kapacitetet e disponueshme të cilat e arsyetojnë atë;

(b) shoqërohen me një plan të masave të përshtatshme për tejkalimin e kufizimeve.

Për më tepër, përjashtimet nuk duhet që:

(i) padrejtësisht të paragjykojnë qëllimet e kësaj Rregulloreje;

(ii) shkaktojnë çrregullime të konkurrencës ndërmjet furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe/ose përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit;

(iii) zgjerohen më shumë sesa është e nevojshme.

9.3 AAC-ja duhet të informojë Komisionin Evropian për çdo përjashtim që propozon ta aprovojë në bazë të paragrafit 1, tre muaj para se të hyjë në fuqi. Pas marrjes në konsideratë të shpjegimit për përjashtim dhe në konsultim me AAC-në, Komisioni Evropian brenda tre muajsh prej kohës së pranimit të këtij shpjegimi, mund të aprovojë ose të kundërshtojë atë, por gjithashtu mund të kërkojë nga AAC-ja që të ndryshojë shtrirjen e përjashtimit ose të kufizojë atë në ato pjesë të aeroportit ku kufizimet e dyshuara janë vërtetuar se ekzistojnë.

9.4 Organi menaxhues i aeroportit do të informohet në lidhje me vendimin nga paragrafi 1, vendimi gjithashtu do të publikohet në faqen zyrtare të aeroportit në fjalë dhe duhet t'i vihet në dispozicion të gjithë furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të aeroportit.

9.5 Përjashtimet e aprovuara nga AAC-ja në bazë të paragrafit 1, nuk mund të zgjasin më shumë se një periudhë tre vjeçare, përveç përjashtimeve të aprovuara nën pikën (b). Jo më vonë se tre muaj para përfundimit të kësaj periudhe, AAC-ja do të marrë një vendim të ri për çdo kërkesë për përjashtim, e i cili gjithashtu do t'i nënshtrohet procedurës së përcaktuar me këtë nen.

9.6 Përfashtimet nën paragrafin 1(b) nuk mund të tejkalojnë kohëzgjatjen prej dy vitesh. Megjithatë, AAC-ja, në bazë të dispozitave të paragrafit 1, mund të kërkojë që kjo periudhë të zgjatet me një periudhë të vetme prej dy vitesh. Komisioni i cili i asiston Komitetit, e i cili referohet në nenin 10, do të vendosë për një kërkesë të tillë.

Neni 10 **Komiteti këshillëdhënës**

10.1 Komisioni duhet të asistohet nga një komitet këshillëdhënës i përbërë nga përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së dhe përfaqësuesi i Komisionit.

10.2 Komisioni do të këshillohet nga Komiteti i referuar në paragrafin 1, për aplikimin e nenit 9.

10.3 Komiteti mundet më tutje të konsultohet për çfarëdo çështje tjetër në lidhje me aplikimin e kësaj Rregulloreje.

10.4 Komisioni duhet ta konsultojë AAC-në dhe AAC-së duhet t'i jepet mundësia për të dhënë këshillën apo mendimin e vet për çfarëdo çështje që ka të bëjë me aplikimin e kësaj Rregulloreje.

10.5 Aty ku referohet ky nen, do të aplikohen nenet 3, 7 dhe 8 të Vendimit 1999/468/ KE ndryshuar me Vendim të Këshillit 2006/512.¹

Neni 11 **Aprovimi**

11.1 Aty ku numri i furnizuesve për kategori të caktuara të shërbimeve në tokë nuk është i kufizuar si dhe për vetëshërbim në pajtim me nenin 6 të kësaj Rregulloreje, secili furnizues i shërbimeve në tokë dhe secili vetëshërbyes (secili referohet tani e tutje si "aplikues") duhet të aplikojë me shkrim në AAC për aprovim, para angazhimit në aktivitetet e shërbimit në tokë në një aeroport.

11.2 AAC-ja do të japë aprovim sipas kësaj Rregulloreje kur një aplikues:

(a) është kompetent, sa i përket përvojës, burimeve financiare, pajisjeve, personelit, procedurave të mirëmbajtjes dhe operimit për të ofruar siguri e sigurim të objekteve, avionit, pajisjeve dhe personave, dhe

(b) është i siguruar në mënyrë adekuate për të mbuluar detyrimin ndaj punonjësve, udhëtarëve, bagazhit, ngarkesës, postës dhe palëve të treta.

(a) ¹ Vendimi i Këshillit 2006/512 i datës 17 korrik 2006 që ndryshon Vendimin 1999/468/KE (EC) të datës 28 korrik 1999 që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave që i janë dhënë Komisionit.

11.3 AAC-ja duhet të përcaktojë brenda tre muajsh të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje kriteret nga paragrafi 2 i këtij neni, të aplikueshme në aeroportet që hyjnë në fushëveprimin e kësaj Rregulloreje. Këto kriteret duhet të publikohen.

11.4 AAC-ja duhet në mënyrë të vazhdueshme të monitorojë, dhe nëse është e nevojshme, të tërheqë çdo aprovim i cili është dhënë sipas kësaj Rregulloreje kur poseduesi i aprovimit dështon në plotësimin e kushteve të referuara në paragrafin 2.

11.5 Kurdo që AAC-ja vendos ta refuzojë ose të tërheqë një aprovim të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje, arsyeja për refuzimin ose tërheqjen e një aprovimi të tillë do t'i bëhet e njohur me shkrim furnizuesit të shërbimeve në tokë ose vetëshërbyesit në fjalë dhe gjithashtu organit menaxhues të aeroportit përkatës.

11.6 Si përjashtim nga paragrafi 1, në rastet ku, në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, organi menaxhues i aeroportit ofron shërbime në tokë për palët e treta, ai do të konsiderohet si furnizues i aprovuar për të gjitha kategoritë e shërbimeve në tokë të cilat i ofron në atë moment, në atë aeroport, për një periudhë kohore njëvjeçare nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

11.7 AAC-ja, në pajtim me nenin 25.1 (a) të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe aktet nënligjore për tarifën e ngarkuar nga AAC-ja, do të përcaktojë shkallën e tarifave që do të vendosen në lidhje me çdo aprovim të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 12 **Zgjedhja e furnizuesve**

12.1 AAC-ja do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për organizimin e procedurës së zgjedhjes së furnizuesve të autorizuar për ofrimin e shërbimeve në tokë në një aeroport ku numri i tyre është i kufizuar në rastet e parashikuara me nenin 7.3 apo nenin 9.

12.2 Çdo furnizues i shërbimeve në tokë, i cili është i regjistruar në përputhje me ligjin për të ofruar shërbime në tokë, e që ka një adresë zyrtare biznesi në territorin e ndonjëres prej palëve kontraktuese të Marrëveshjes HPEA, mund të aplikojë.

12.3 Procedura e zgjedhjes duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet në vijim:

(a) Një ftesë për tenderim duhet të lëshohet dhe të publikohet në pajtim me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës.

(b) Furnizuesit e shërbimeve në tokë do të zgjedhen:

(i) pas konsultimit me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit nga organi menaxhues i aeroportit, me kusht që ky i fundit:

- nuk ofron shërbime të njëjta në tokë; dhe
- nuk ka kontroll direkt ose indirekt mbi ndonjë ndërmarrje e cila ofron shërbime të tilla; dhe
- nuk është i përfshirë në ndonjë ndërmarrje të tillë;

(ii) në të gjitha rastet tjera, nga AAC-ja, e cila duhet të konsultohet së pari me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit dhe me organ menaxhues përkatës.

(c) Furnizuesit e shërbimeve në tokë do të zgjedhen për një periudhë deri në shtatë vite.

(d) Kur një furnizues i shërbimeve në tokë ndërprente aktivitetet e veta para se të përfundojë periudha për të cilën ai është zgjedhur, ai do të zëvendësohet në bazë të procedurës së njëjtë.

12.4 Kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese dhe duhet që, përveç tjerash, të përfshijnë specifikimet teknike dhe standardet e përcaktuara për një aeroport në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit.

12.5 Pas përcaktimit të kriterëve përzgjedhëse, duhet të publikohet një ftesë për tenderim e cila do të specifikojë së paku:

(a) kategorinë e shërbimeve në tokë për të cilat është hapur procedura e tenderimit,

(b) kushtet që duhet t'i plotësojë furnizuesi i shërbimeve në tokë në lidhje me:

- përvojën e kënaqshme,
- situatën e mirë financiare,
- strukturën e duhur organizative,
- mbulesën e mjaftueshme të sigurimit civil,
- sigurinë dhe sigurimin e instalimeve, të avionit, pajisjeve dhe personave,

(c) kohëzgjatjen e kontratës së furnizuesit të përzgjedhur,

(d) kriteret e përzgjedhjes,

(e) afatin e fundit për dorëzimin e ofertës

(f) afatin e fundit për shpalljen e fituesit të tenderit dhe

(g) të drejtën për ankesë.

12.6 Aty ku numri i furnizuesve të shërbimeve në tokë është i kufizuar në pajtim me nenin 7.3 apo nenin 9, organi menaxhues i aeroportit mundet vetëvetiu të ofrojë shërbime në tokë pa iu nënshtruar procedurës së zgjedhjes të përcaktuar me këtë nen. Ngjashëm, pa e dorëzuar atë në procedurën e cekur, mund të autorizojë një ndërmarrje që të ofrojë shërbime në tokë në aeroportin në fjalë:

- nëse kontrollon në mënyrë direkte ose indirekte atë ndërmarrje; ose
- nëse ndërmarrja kontrollon atë në mënyrë direkte ose indirekte.

12.7 Organi menaxhues i aeroportit duhet të informojë Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit për vendimet e marra sipas këtij neni.

Neni 13 Konsultimet

AAC-ja do të kujdeset që një procedurë e detyrueshme e konsultimit në lidhje me aplikimin e kësaj Rregulloreje të jetë organizuar ndërmjet organit menaxhues të aeroportit, Komitetit të Përdoruesve të Aeroportit dhe ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime në tokë. Këto konsultime, mes tjerash, do të mbulojnë, çmimin e këtyre shërbimeve në tokë për të cilat është aprovuar përjashtimi në mbështetje të nenit 9.1(b) dhe organizimin e ofrimit të këtyre shërbimeve. Konsultimet e tilla do të organizohen së paku një herë në vit.

Neni 14 Rregullat e sjelljes

AAC-ja, aty ku është e përshtatshme sipas propozimit të organit menaxhues të aeroportit, mund të:

- ndalojë një furnizues të shërbimeve në tokë ose një përdorues të aeroportit që të furnizojë me shërbime në tokë ose të bëjë vetëshërbim, nëse ai furnizues ose përdorues dështon në respektimin e rregullave të cilat i janë imponuar për të siguruar funksionim adekuat të aeroportit;

Këto rregulla duhet të përputhen me parimet në vijim:

- (a) ato duhet të aplikohen në mënyrë jo-diskriminuese ndaj furnizuesve të ndryshëm të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të aeroportit;
- (b) ato duhet të ndërlidhen me qëllimin e synuar;
- (c) ato, në praktikë, nuk mund të kufizojnë qasjen në treg ose lirinë për vetëshërbim nën nivelin që është përcaktuar me këtë Rregullore;

- në veçanti, të kërkojë nga furnizuesit e shërbimeve në tokë në aeroport që të marrin pjesë në një mënyrë të drejtë dhe jo-diskriminuese në kryerjen e obligimeve të shërbimeve publike të përcaktuara në ligjet dhe rregullat e Republikës së Kosovës, duke përfshirë obligimin për të siguruar shërbim të vazhdueshëm.

Neni 15 **Qasja në objekte**

15.1 AAC-ja do të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se furnizuesit e shërbimeve në tokë dhe përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen të kenë qasje në objektet e aeroportit deri në atë shkallë që është e nevojshme për të kryer aktivitetet e tyre. Nëse organi menaxhues i aeroportit, apo siç mund të jetë rasti, autoriteti publik apo ndonjë organ tjetër i cili e kontrollon atë, vendos kushte për një qasje të tillë, këto kushte duhet të jenë relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

15.2 Hapësira e disponueshme për shërbime në tokë në një aeroport duhet të ndahet ndërmjet furnizuesve të ndryshëm të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit, duke përfshirë operatorët e rinj në këtë fushë, deri në atë masë që është e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të tyre dhe për të lejuar konkurrin të drejtë dhe efektiv, në bazë të kriterëve dhe rregullave relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

15.3 Aty ku qasja në objektet e aeroportit shkakton mbledhjen e një tarife, kjo e fundit do të aprovohet nga AAC-ja në konsultim me Komitetin e Përdoruesve të Aeroportit. Çfarëdo tarife e tillë duhet të jetë e lidhur me koston dhe e bazuar në kriteret relevante, objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Neni 16 **Siguria dhe sigurimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në të drejtat dhe obligimet sa i përket ligjit dhe rendit, sigurisë dhe sigurimit në aeroporte.

Neni 17 **Mbrojtja sociale dhe mjedisore**

Pa paragjykuar aplikimin e kësaj Rregulloreje, dhe duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të Marrëveshjes HPEA, AAC-ja ose ndonjë autoritet tjetër kompetent në Republikën e Kosovës mund të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar mbrojtje të të drejtave të punëtorëve dhe respektimin e mjedisit.

Neni 18 Ndëshkimet

Ndëshkimet për dështim në zbatimin e kësaj Rregulloreje do të rregullohen me dispozitat ndëshkimore të përcaktuara në Titullin IV të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

Neni 19 Reciprociteti

19.1 Pa paragjykuar zotimet ndërkombëtare që dalin nga Marrëveshja HPEA, kurdo që të shihet se një shtet i tretë, sa i përket qasjes në tregun e shërbimit në tokë ose vetëshërbimit:

- (a) *de jure* apo *de facto*, nuk u jep furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit nga Republika e Kosovës një trajtim të krahasueshëm me atë që i jepet furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit të atij shteti nga Republika e Kosovës ; ose
- (b) *de jure* apo *de facto*, nuk u jep furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit të Republikës së Kosovës trajtim nacional; apo
- (c) u jep furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit nga vendet e treta trajtime më të favorshme sesa furnizuesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve vetëshërbyes të aeroportit nga Republika e Kosovës;

AAC-ja mundet që në tërësi ose pjesërisht të suspendojë obligimet e dala nga kjo Rregullore në lidhje me furnizuesit e shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të aeroportit nga ai vend i tretë, në pajtim me Marrëveshjen HPEA.

19.2 AAC-ja duhet të informojë Komitetin e Përbashkët për çdo tërheqje ose suspendim të të drejtave apo obligimeve të marra sipas këtij neni.

Neni 20 E drejta për ankesë

20.1 Çdo vendim ose masë individuale në mbështetje të nenit 6.2 dhe neneve 11-15 të kësaj Rregulloreje do të merret në pajtim të plotë dhe do t'i nënshtrojë të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira, në dispozitat përkatëse të ligjit të përgjithshëm në fuqi.

20.2 Ankimimi administrativ mund të inicohet te Komisioni për Ankesa i AAC-së (“Komisioni për Ankesa”) kundër vendimit final dhe ose masave individuale të marra nga organi menaxhues i aeroportit ose kundër heshtjes ose mosveprimit për të nxjerrë një vendim ose masë individuale në mbështetje të paragrafit 1 të këtij neni, duke aplikuar hapat e veprimit në vijim:

- a. Ankesa duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve kalendarike nga data në të cilën është marrë vendimi ose masa individuale e kontestuar ose 60 ditë nga data kur lëshimi i vendimit ose i masës individuale është refuzuar paligjshmërisht,
- b. Aty ku, sipas pikës (a), Komisioni për Ankesa pranon një ankesë, atëherë kërkon nga organi menaxhues i aeroportit t’i dorëzojë brenda 10 ditëve kalendarike përgjigjen e vet në lidhje me ankesën,
- c. Përgjigjia e pranuar nga organi menaxhues i aeroportit, ashtu siç referohet më lart në pikën (b), do t’i përcillet ankuesit pa vonesë duke kërkuar përgjigjen e ankuesit ndaj paraqitjes së tillë brenda 10 ditëve kalendarike.
- d. Para se të silltet vendimi final për një ankesë, Komisioni për Ankesa mund të kërkojë nga ankuesi, organi menaxhues ose nga secili person tjetër i përfshirë, informata të tilla të cilat i gjykon të nevojshme për të mundësuar marrjen e vendimit për ankesën.
- e. Atëherë kur të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara me ligjin në fuqi të jenë përmbushur, duke përfshirë edhe pikat e referuara më lart nën (a), (b) (c) dhe (d), Komisioni për Ankesa do të rishikojë ankesën dhe mund të marrë cilindo vendim si në vijim:
 - i. lënien në fuqi të vendimit ose masës individuale dhe rrëzimin e ankesës;
 - ii. shfuqizimin/revokimin e vendimit ose masës individuale dhe pranimin e ankesës;
 - iii. ndryshimin e vendimit ose masës individuale duke pranuar pjesërisht ankesën;
 - iv. detyrimin e organit menaxhues të aeroportit për të nxjerrë vendimin ose masën individuale kur është refuzuar pa të drejtë nxjerrja e tij.
- f. Komisioni për Ankesa do të njoftojë ankuesin dhe organin menaxhues të aeroportit ose çdo person për vendimin sipas pikës (e) duke dhënë arsyet për të.
- g. Çdo vendim final ose masë individuale e marrë nga organi menaxhues i aeroportit në mbështetje të paragrafit 1 të këtij neni, kundër të cilit është paraqitur një ankesë te Komisioni për Ankesa, nuk mund të

implementohet para se të jetë marrë vendimi final nga ky i fundit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligjin e përgjithshëm në fuqi.

- h. Vendimi i Komisionit për Ankesa lidhur me një ankesë do të merret brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e dorëzimit të ankesës nën pikën (a), ose brenda 15 ditëve kalendarike pas datës në të cilën organi menaxhues i aeroportit ka vendosur që ta refuzojë kërkesën për rishikimin e vendimit të vet.
- i. Vendimi i Komisionit për Ankesa do të jetë përfundimtar dhe kundër tij nuk mund të ushtrohet ankesë më tutje, përveç të drejtës së palëve me interes që të paraqesin padi para gjykatës kompetente për fillimin e një konflikti administrativ.
- j. Vendimi nga pika (i) , kundër të cilit është paraqitur padi për fillimin e konfliktit administrativ para gjykatës kompetente, mund të ekzekutohet brenda 15 ditëve nga data e hyrjes së tij në fuqi, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligjin e përgjithshëm në fuqi.

20.3 Kërkesa për rishikim të çdo vendimi dhe mase individuale të nxjerrë nga AAC-ja sipas nenit (neneve) përkatës të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të paraqitet në Komisionin për Ankesa brenda 15 ditëve kalendarike, pas datës në të cilën është marrë vendimi i kontestuar.

20.4 Pas shqyrtimit dhe pranimit të një kërkesë të tillë për rishikim, Komisioni për Ankesa brenda 30 ditëve kalendarike do të vendosë, nëse duhet të revokohet, të ndryshohet ose të tërhiqet vendimi i ankimuar i AAC-së.

20.5 Nëse vendimi nga paragrafi 3 konfirmohet, nuk mund të ushtrohen ankesa të mëtutjeshme. Në këtë rast, mund të inicohet konflikti administrativ para gjykatës kompetente të Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin e përgjithshëm në fuqi.

20.6 Çdo kërkesë e palës me interes, në mbështetje të paragrafit 1 të këtij neni, të cilës nuk i është adresuar me kohë, ashtu siç është përcaktuar me ligjin e përgjithshëm në fuqi, mund të jetë shkas për ngritjen e ankesës për mosveprim ose heshtje pranë Komisionit për Ankesa. Në raste të tilla, Komisioni për Ankesa mund të kërkojë nga autoriteti përgjegjës në AAC nxjerrjen e vendimit ose masës individuale, kur lëshimi i tij ka qenë i refuzuar paligjshëm.

20.7 Vendimi i marrë nga Komisioni për Ankesa nën këtë paragraf nuk mund të apelohe më tutje, megjithatë, mund t'i japë të drejtë palës me interes për të paraqitur padi për konflikt administrativ para gjykatës kompetente.

20.8 AAC-ja mund të lëshojë udhëzime të tjera, të cilat do t'i drejtojnë palët për procedimet e brendshme administrative që duhen ndjekur, kur ushtrojnë të drejtën

për ankesë në lidhje me vendimin ose masat individuale të marra nga AAC-ja, në mbështetje të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 21 Raportimi

21.1 AAC-ja do t'i komunikojë Komisionit informatën e kërkuar që të hartojë një raport për aplikimin e kësaj Rregulloreje. Raporti duhet të shoqërohet nga ndonjë propozim për rishikimin e Rregullores.

21.2 AAC-ja do t'i komunikojë Komisionit tekstin e kësaj Rregulloreje dhe dispozitat kryesore të ligjit të Republikës së Kosovës të cilat i adopton në fushën që mbulohet me këtë Rregullore.

Neni 22 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 30 maj 2011.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm

SHTOJCË LISTA E SHËRBIMEVE NË TOKË

1. Administrimi dhe mbikëqyrja në tokë përfshijnë:
 - 1.1. shërbime përfaqësimi dhe ndërlidhëse me autoritetet lokale ose ndonjë entitet tjetër, pagesat në emër të përdoruesve të aeroportit dhe ofrimin e hapësirës për zyrat e përfaqësuesve të vet;
 - 1.2. kontrolli i ngarkimit (load control), lajmërimet dhe telekomunikimet;
 - 1.3. përpunimi, deponimi dhe administrimi i njësisë me pajisje për ngarkim;
 - 1.4. çdo shërbim tjetër mbikëqyrës para, gjatë ose pas fluturimit dhe çdo shërbim tjetër administrativ që kërkohet nga përdoruesi i aeroportit.
2. Shërbimi (handling) i udhëtarëve përfshin çdo lloj të asistencës në arritje, nisje, transferim ose transit udhëtarësh, duke përfshirë kontrollin e biletave dhe dokumenteve të udhëtimit, regjistrimin e bagazhit dhe bartjen e tyre deri në zonën e sortimit.
3. Përpunimi (handling) i bagazhit përfshin trajtimin e bagazhit në zonën e sortimit, sortimin e tij, përgatitjen e tij për nisje, ngarkimin në dhe shkarkimin prej pajisjes së dizajnuar për ta lëvizur bagazhin nga avioni në zonën e sortimit dhe anasjelltas, e gjithashtu edhe transportimin e bagazhit prej zonës së sortimit deri në zonën e marrjes së bagazhit.
4. Përpunimi (handling) i mallrave dhe postës përmban:
 - 4.1. për mallra: përpunimin fizik të mallrave që eksportohen, transferohen dhe importohen, përpunimin e dokumenteve përkatëse, procedurat doganore dhe implementimin e çdo procedure të sigurimit e dakorduar ndërmjet palëve ose kur e kërkojnë rrethanat;
 - 4.2. për postën: përpunimin fizik të postës hyrëse dhe dalëse, trajtimin e dokumenteve relevante dhe implementimin e çdo procedure të sigurimit të dakorduar ndërmjet palëve ose kur e kërkojnë rrethanat.
5. Përpunimi në platformë përfshin:
 - 5.1. udhëheqjen e avionit në tokë gjatë arritjes dhe nisjes (*);
 - 5.2. asistencën për avionin në lidhje me paketimin dhe ofrimin e pajisjeve të përshtatshme (*);
 - 5.3. komunikimin ndërmjet avionit dhe ofruesit të shërbimeve në pjesën ajrore (*);
 - 5.4. ngarkimin dhe shkarkimin e avionit, duke përfshirë ofrimin dhe operimin e mjeteve përkatëse, e gjithashtu edhe transportimin e ekuipazhit dhe udhëtarëve ndërmjet avionit dhe terminalit, dhe transportimin e bagazhit ndërmjet avionit dhe terminalit;
 - 5.5. ofrimin dhe operimin e njësive përkatëse për startimin e motorit;
 - 5.6. lëvizjen e avionit gjatë arritjes dhe nisjes, e gjithashtu edhe ofrimin e dhe operimin e pajisjeve përkatëse;
 - 5.7. transporti, ngarkimi dhe shkarkimi nga avioni i ushqimit dhe pijeve.
6. Shërbimet e avionit përmbajnë:

- 6.1. pastrimin e jashtëm dhe të brendshëm të avionit, të tualeteve si dhe shërbimet me ujë;
- 6.2. ftohjen dhe ngrohjen e kabinës, largimin e borës dhe akullit, dhe shkrirjen e akullit nga avioni;
- 6.3. rirregullimi i kabinës me pajisje përkatëse të kabinës, dhe deponimi i këtyre pajisjeve.
7. Shërbimi (handling) me derivate dhe vajra përfshin:
 - 7.1. organizimin dhe ekzekutimin e operacioneve për mbushje dhe zbrazje të derivateve, duke përfshirë deponimin e derivateve dhe kontrollin e cilësisë dhe sasisë të derivateve;
 - 7.2. furnizimin e vajrave dhe fluideve tjera.
8. Mirëmbajtja e avionit përfshin:
 - 8.1. servisimet e zakonshme që kryhen para fluturimit;
 - 8.2. servisimet jo të zakonshme që kërkohen nga përdoruesi i aeroportit;
 - 8.3. ofrimi dhe administrimi i pjesëve rezervë dhe pajisjeve të përshtatshme;
 - 8.4. kërkesat për rezervimin e vendparkimit të përshtatshëm dhe/ose hapësirës së hangarit.

(*) Me kusht që këto shërbime nuk ofrohen nga shërbimi i trafikut ajror.

9. Operimi i fluturimeve dhe administrimi i ekuipazhit përfshin:
 - 9.1. përgatitjen e fluturimit në aeroportin e nisjes ose në çfarëdo pike tjetër;
 - 9.2. asistencën gjatë fluturimit, duke përfshirë rilokimin nëse ka nevojë;
 - 9.3. aktivitetet pas fluturimit;
 - 9.4. administrimin e ekuipazhit.
10. Transporti sipërfaqësor përfshin:
 - 10.1. organizimin dhe bartjen e ekuipazhit, udhëtarëve, bagazhit, mallrave dhe transportimin e postës ndërmjet terminaleve të ndryshme të aeroportit të njëjtë, por me përjashtim të të njëjtit transport ndërmjet avionit dhe çfarëdo pike tjetër brenda perimetrit të aeroportit të njëjtë;
 - 10.2. çfarëdo transporti të veçantë që kërkohet nga përdoruesi i aeroportit.
11. Shërbimet për furnizim me ushqim përfshijnë:
 - 11.1. ndërlidhje me furnizuesit dhe menaxhimin administrativ;
 - 11.2. deponimin e ushqimit, pijeve dhe pajisjeve të nevojshme për përgatitjen e tyre;
 - 11.3. pastrimin e këtyre pajisjeve;
 - 11.4. përgatitjen dhe dorëzimin e pajisjeve e gjithashtu furnizimin me ushqim dhe pije.